

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISSIONI NË KOSOVË

Raporti 02/2007 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 1 mars 2007 – 13 maj 2007

Titujt kryesor

- Kuvendi miraton deklaratën për mbështetjen e propozimit të të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës
- Gjashtë ish-deputetë të LDK-së formojnë grup të ri parlamentar të quajtur “Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)”
- Ministri për Ekonomi dhe Financa paraqitet në interpelancë lidhur me blerjen e veturës së blinduar nga Kryetari i mëparshëm i Kuvendit
- Kuvendi diskuton për protestën e ‘Vetëvendosjes’ mbajtur më 20 shkurt

Raporti i pesëdhjetenjëtitë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur tetë seanca plenare të rregullta, më 14 mars, 16 mars, 22 mars, 30 mars, 5 prill, 13 prill, 27 prill dhe 10 maj si dhe shtatë mbledhje të Kryesisë, më 5 mars, 12 mars, 27 mars, 10 prill, 23 prill, 25 prill dhe 7 maj. Dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike kanë mbajtur mbledhje gjatë periudhës raportuese.¹ Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 31 prej 61 mbledhjeve të komisioneve dhe tri dëgjime publike.²

¹ Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 20 dhe 29 mars, 10 dhe 17 prill dhe 9 maj derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 5, 12 dhe 26 mars, 2, 11 dhe 18 prill dhe 8 maj. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 5 dhe 19 mars, 2 dhe 16 prill dhe 2 maj derisa Komisioni për siguri është takuar më 14 dhe 21 mars, 4 dhe 25 prill. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 27 mars, 25 prill dhe 8 maj derisa Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 6, 22 dhe 27 mars, 10, 17 dhe 26 prill dhe 3 maj. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 6, 12, 13 dhe 27 mars, 2, 10 dhe 24 prill dhe 8 maj derisa Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 6, 13, 20 dhe 27 mars, 8, 10, 17 dhe 24 prill dhe 8 maj. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 7, 13, 19 dhe 23 mars, 3, 10, 17 dhe 26 prill dhe 4 e 8 maj derisa Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet Euro-Atlantike është takuar më 9 dhe 21 mars dhe 4 prill. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe kërkesa dhe parashtrësia publike është takuar më 21 dhe 28 mars, 6, 12 dhe 26 prill dhe 9 maj. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 27 mars 2007 ka mbajtur dëgjimin publik lidhur me themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Kosovës. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport, më 18 prill 2007 ka mbajtur dëgjimin publik mbi zbatimin e ligjit për kinematografi. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 24 prill ka mbajtur dëgjimin publik mbi situatën në fushën e arsimit. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media më 3 prill ka mbajtur dëgjimin lidhur me mos zbatimin e ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 3 prill 2007 ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për ndryshimin e ligjit për planifikim hapësinor.

² Komisioni për buxhet dhe financa më 20 dhe 29 mars, 17 prill dhe 9 maj; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 5, 12 dhe 26 mars, 2, 11 dhe 18 prill dhe 8 maj; Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese më 5 dhe 19 mars, 2 dhe 16 prill dhe 2 maj; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 13 dhe 27 mars dhe 2 prill; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 7, 13, 19 dhe 23 mars, 3 prill dhe 8 maj; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 6, 20 dhe 27 mars dhe 17 prill; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar

1. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 14 mars e kryesoi anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Nëntëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 14 marsit.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 14 marsit:
 - Debati mbi përfundimin e negociatave për statusin, të mbajtur në Vjenë (Të gjithë anëtarët e Ekipit të Unitetit bënë deklaratë pasuar nga shefat e grupeve parlamentare dhe nga deklaratë përmbyllëse e Kryetarit të Kosovës.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 16 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Tetëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 16 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 16 marsit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për banimin dhe vendqëndrimin (Projektligji është miratuar në parim me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 2003/14 për planifikimin hapësinor (Projektligji është miratuar në parim me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Debati për licensimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile nga ana e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (Kjo pikë është shtyrë me kërkesë të sponzoruesit.)
 - Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur të Ankesave (Emërimi është miratuar me 46 vota për dhe 24 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjykatësve (Rekomandimi është refuzuar me 32 vota për dhe 36 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i projektprogramit dhe kalendarit të punës së Kuvendit për vitin 2007 (Projektprogrami dhe kalendari janë miratuar me 58 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Autoritetit Bankar Qendror (Propozimi është miratuar me 38 vota për dhe 26 vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 22 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Tetëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 22 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 22 marsit:
 - Debati për licensimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile nga ana e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (Z. Demir Lima (PDK) si propozues i debatit bëri deklaratë pasuar nga Shefi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit z. Anton Berisha, Kryeministri Agim Çeku, shefat e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të tjerë. Në fund të debatit Kryesuesi e vëri në votim propozimin e z. Lima për auditim të pavarur të procesit të tenderimit për licensimin e

dhe integritet Euro-Atlantike më 21 mars dhe 4 prill. Dëgjimin publik të projektligjit për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor më 3 prill; dëgjimin publik për mënyrën e zbatimit të ligjit për kinematografinë më 18 prill; dhe dëgjimin publik lidhur me situatën në section e arsimit më 24 prill.

³ Përveç nëse është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër në këtë raport, kjo është shifra e njoftuar nga Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi në fillim të ditës.

operatorit të dytë të telefonisë mobile, i cili është refuzuar me 30 vota për, 32 vota kundër dhe dy abstenime.)

- Debat lidhur me protestën e datës 10 shkurt 2007
(Z. Emrush Xhemajli (LPK) si propozues i debatit bëri deklaratë pasur nga Ministri i Punëve të Brendshme Blerim Kuçi, z. Naim Maloku kryetar i komisionit për siguri, shefat e grupeve parlamentare, disa deputetë dhe deklaratë përmbyllëse e z. Xhemajli.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 30 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtar i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 30 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 30 marsit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Interpelanca e ORA-s për Ministrin për Ekonomi dhe Financa (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Interpelanca”.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Mbrojtjen nga Zhurma (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Bletarinë (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për kthimin e Projektligjit për ditën e dëshmorëve Qeverisë (Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Procesi legjislativ.”)

Seancën plenare të posaçme të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 5 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK).

- Njëqind e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 5 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 5 prillit:
 - Miratimi i deklaratës për mbështetjen e propozimit të të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës
(Të gjithë anëtarët e Ekipit të Unitetit bënë deklaratë pas së cilave deklaratë për mbështetjen e propozimit të të dërguarit special të OKB-së është miratuar unanimisht me vetëm një votë kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 13 prill e kryesoi anëtar i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Tetëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 13 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 13 prillit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për bujqësinë organike (Projektligji është miratuar në parim me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për transfuzionin e gjakut (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për emrin personal (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për numrin personal (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit të përgatitur nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion mbi monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve (Raporti me rekomandime i komisionit është miratuar me shumicë votash për dhe një votë kundër.)

- Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2006 (Raporti është miratuar me 44 vota për dhe 18 vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27 prill e kryesoi anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e gjashtë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 27 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27 prillit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse (Projektligji është shtyrë me kërkesë të Komisionit funksional.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për kimikatet (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 10 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 10 majit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 10 majit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për shoqëritë tregtare (Projektligji është miratuar në parim me shumicë votash për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe dy vota kundër.)
 - Debat për raportin e shpenzimeve për vitin 2006 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (Raporti është miratuar me 45 vota për dhe 22 vota kundër.)
 - Debat lidhur me arsimin fillor dhe të mesëm (Z. Enver Hoxhaj (PDK) si sponsorues i debatit bëri deklaratë pasuar nga Ministri për arsim, shkencë dhe teknologji Agim Veliu, shefat e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të tjerë nga grupe të ndryshme parlamentare. Në fund të debatit rekomandimet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport janë miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Konkurrencës (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit.)
 - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Ambient dhe Planifikim Hapësinor lidhur me themelimin e Bordit për Ujërat (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me projektligjin për ndërmjetësimin (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit.)

2. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 16 marsit, z. Alush Gashi (LDK) në emër të grupit parlamentar të LDK-së propozoi *me shkrim* që në rendin e ditës të futet propozimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e z. Gashi që u miratua me shumicë votash për. Në fillim të seancës plenare të 30 marsit, znj. Teuta Hadri (PDK) *gojarisht* propozoi që çështja e sistemit shëndetësor të përfshihet në rendin e ditës. Në seancën e njëjtë plenare z. Xhevat Bislimi (PDK) *gojarisht* propozoi që ngritja e tarifave të energjisë për ekonomitë familjare të debatohet gjatë seancës plenare në fjalë. Kryesuesi kërkoi opinionin e shefave të grupeve parlamentare lidhur me propozimet e znj. Hadri dhe z. Bislimi, të cilët në përgjithësi i

mbështetën propozimet por deklaruan se propozimet nuk mund të diskutohen gjatë asaj seance sepse duhet të ketë material të nevojshëm për të dy çështjet dhe më shumë kohë për t'u përgatitur para mbajtjes së këtyre diskutimeve. Andaj, Kryesuesi i këshilloi znj. Hadri dhe z. Bislimi t'i parashtronjë propozimet e tyre në zyrën për parashtrësia.

Në fillim të seancës plenare të 13 prillit, Kryesuesi lajmëroi se grupi parlamentar i SLKM-së ka propozuar *me shkrim* heqjen e shqyrtimit të dytë të projektligjit për emrin personal dhe shqyrtimin e dytë të projektligjit për numrin personal nga rendi i ditës së seancës plenare. Kryesuesi e vëri në votim propozimin i cili u refuzua me shumicë votash kundër.

Në fillim të seancës plenare më 10 maj, Kryetari i Kuvendit deklaroi se nuk ka marrë asnjë propozim me shkrim për ndryshimin e rendit të ditës andaj në pajtim me rregullën 23.2 rendi i ditës konsiderohet i miratuar. Znj. Safete Hadërgjonaj (PDK) megjithatë kërkoi që të flasë lidhur me rendin e ditës dhe Kryetari i Kuvendit i lejoi ta bëjë këtë. Ajo propozoi *gojarisht* që pika e rendit të ditës – debati për raportin e shpenzimeve për vitin 2006 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – të heqet nga rendi i ditës me arsyetimin se Komisioni për Buxhet nuk kishte mundur ta shqyrtoj raportin para mbajtjes së debatit për shkak të mungesës së Ministrit për Ekonomi dhe Financa në mbledhjet e komisionit. Kryetari i Kuvendit u lejoi shefave të grupeve parlamentare të deklarohen lidhur me propozimin e znj. Hadërgjonaj dhe më pas e vëri në votim propozimin e znj. Hadërgjonaj i cili është refuzuar me shumicë votash kundër. Menjëherë pas votimit z. Gjergj Dedaj (Për Integritim/PLK) poashtu kërkoi që të flas për rendin e ditës duke deklaruar se ka propozim për të bërë por Kryetari i Kuvendit nuk e lejoi me arsyetimin se nuk mund të ketë më tepër diskutime për rendin e ditës meqë asnjë propozim me shkrim për ndryshimin e rendit të ditës nuk ishte parashtruar para fillimit të seancës, dhe vazhdoi me pikën e radhës. Z. Dedaj megjithatë insistoi që të flas për rendin e ditës duke debatuar se ai ka të drejtë të flas dy minuta për rendin e ditës. Por, Kryetari i Kuvendit nuk i lejoi atij të flas dhe z. Dedaj e lëshoi sallën plenare në shenjë proteste.

Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Propozimi i z. Gashi dhe ai i SLKM-së, të parashtruar me shkrim para fillimit të seancës plenare, janë bërë në pajtim me rregullat e reja. Por, z. Bislimi, znj. Hadri dhe znj. Hadërgjonaj bënë propozime me gojë në pajtim me rregullën e mëparshme,⁴ e cila nuk është në fuqi nga qershori i vitit 2006, dhe e cila lejonte që propozimet për ndryshimin e rendit të ditës të bëheshin me gojë. Rregulla 22.7 parasheh që “diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjat më shumë se dy (2) minuta”. Kjo dispozitë nuk mund të interpretohet si e izoluar, siç pretendonte z. Dedaj në seancën plenare të 10 majit, por si pjesë e tërësisë së dispozitave të Rregullores së Kuvendit. Andaj, parakusht për ta lejuar deputetin ta arsyetojë gojarisht propozimin e tij/saj për ndryshimin e rendit të ditës është që të njëjtin propozim ta dorëzojë me shkrim para seancës plenare, siç parashihet në rregullën 23.2, përndryshe rendi i ditës konsiderohet i miratuar dhe nuk ka nevojë të diskutohet. Z. Dedaj nuk i ishte lejuar ta shtronte gojarisht propozimin e tij, që ishte në pajtim me rregullën 23.2, por znj. Hadërgjonaj, znj. Hadri dhe z. Bislimi megjithatë janë lejuar t'i shtrojnë propozimet e tyre gojarisht, gjë që nuk ishte në pajtim me rregullën 23.2. Qëllimi i ripunimit të dispozitave lidhur me përgatitjen e rendit të ditës në seancën plenare të 1 qershorit 2006 ishte që ta bëjë punën e Kuvendit më të efektshme dhe më të rregullt, por edhe pas ripunimit të dispozitave lidhur me rendin e ditës, deputetëve u është lejuar që të bëjnë propozime gojore lidhur me rendin e ditës⁵ siç përshkruhej në rregullën e vjetër e cila më nuk është në fuqi. Dispozitat e reja, të cilat kërkojnë që propozimet lidhur me rendin e ditës të parashtrohen me shkrim, duhet të

⁴ Rregulla e vjetër 23.1 parashihte që “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose ... gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.”

⁵ Shiko raportet 01/2007, 07/2006, 06/2006 dhe 05/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar “Rendi i ditës”.

respektohen në mënyrë konsistente, e jo në mënyrë selective, me qëllim që të shmanget paqartësia apo paknaqësia në mes deputetëve të Kuvendit.

- Në fillim të seancës plenare të 16 marsit, znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) në emër të grupit parlamentar ORA propozoi që çështja e vaksinave të ndalura në doganë një ditë më parë të përfshihet në rendin e ditës si çështje e ngutshme. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e ORA-s i cili u refuzua me shumicë votash kundër.

Kryetari i Kuvendit e vëri propozimin e ORA-s në pajtim me rregullën 29.2 e cila parasheh që “propozimi i grupeve parlamentare për çështjet urgjente vendoset nga Kuvendi.”

- Në fillim të seancës plenare të 30 marsit, Kryesuesi lajmëroi se z. Ramadan Kelmendi kishte propozimin që në rendin e ditës të përfshihet si pikë e ngutshme diskutimi për ndërtimet ilegale të banesave kolektive në pjesën veriore të Mitrovicës. Kryesuesi kërkoi mendimin e shefave të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e z. Kelmendi, të cilët e përkrahën propozimin në parim por arsyetuan se nuk ishte çështje aq e ngutshme sa të diskutohej gjatë seancës në fjalë duke shtuar se u duheshin informata shtesë nga Qeveria, komuna e Mitrovicës dhe UNMIK-u para se çështja në fjalë të diskutohet në Kuvend. Andaj, Kryesuesi e këshilloi z. Kelmendi ta dorëzojë propozimin e tij në zyrën për parashtrësia.

Rregulla 29.1 parasheh që “Në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje të ngutshme. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t’i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim.” Andaj, ishte në autoritetin e Kryetarit të Kuvendit t’i lejojë z. Kelmendi ta bëjë propozimin e tij.

Debatet

- Në seancën plenare të 10 majit gjatë debatit për arsimin fillor dhe të mesëm, z. Alush Gashi (LDK) propozoi që kufizimi kohor për deklaratat e deputetëve të shkurtohet prej dhjetë në pesë minuta për secilin deputet. Z. Jakup Krasniqi (PDK) poashtu e mbështeti propozimin e z. Gashi. Andaj, Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin për kufizimin e kohës për debat nga dhjetë në pesë minuta për secilin deputet, i cili u miratua me shumicë votash për dhe tetë vota kundër.

Kjo ishte në pajtim me rregullën 22.7 e cila parasheh që “diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se (10) dhjetë minuta për secilin deputet . . . nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe.”

Kryesimi i seancave plenare

- Në fillim të seancës plenare më 16 mars, gjatë debatimit për rendin e ditës, z. Gani Koci (PDK) propozoi që Kryetari i Kuvendit mos ta kryesojë seancën në fjalë duke shtuar se “po e udhëheq në mënyrë të gabuar”. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e z. Koci i cili u refuzua me shumicë votash kundër. Z. Hajredin Kuçi (PDK) propozoi që z. Sabri Hamiti (LDK) i cili po i ndimonte Kryetarit të Kuvendit në udhëheqjen e seancës, të tërhiqej nga bashkëkryesimi duke pohuar se “ai po e influencon menaxhimin e Kuvendit”. Z. Hamiti u përgjigj se ai po e kryente detyrën e tij dhe se z. Kuçi duhet ta respektojë Rregulloren e Punës.

Kreu 9.1.31 të Kornizës Kushtetuese dhe rregulla 8 parashohin që “Kryetari i Kuvendit e përfaqëson Kuvendin, i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit, mbikëqyr rendin dhe ushtron edhe detyra që specifikohen në këtë rregullore të punës.” Është obligim Kushtetues i Kryetarit t’i kryesojë seancat e Kuvendit andaj nuk ai nuk ishte i obliguar ta hedhë në votim propozimin e z. Koci. Ngjashëm, rregulla 10 parasheh që “Në udhëheqjen e punës së seancave të Kuvendit, Kryetarit i ndihmon njëri nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, sipas radhës së caktuar nga Kryesia.” Është e drejtë vetëm e Kryesisë që të vendosë se cilët nga anëtarët e saj do t’i ndihmojnë Kryetarit në kryesimin e seancave plenare.

Gjuha joparlamentare

- Në seancën plenare më 10 maj, gjatë debatit për arsimin fillor dhe të mesëm z. Numan Balić (Për Integritim/SDA) propozoi që të ketë debate publike lidhur me përfshirjen e arsimit fetar në

shkolla. Z. Ymer Muhaxheri (LDK) ka bërë koment,⁶ në të cilin z. Balić u përgjigj “kërkoj nga profesori (z. Muhaxheri) të mos ndërhyjë. Së shpejti do të shkosh në varr, andaj të rekomandoj t’i lutesh Zotit, Krijuesit tënd”.⁷ Në atë moment Kryetari i Kuvendit i ka ndalur mikrofonin z. Balić dhe i ka kërkuar atij t’i tërheq ato fjalë. Z. Balić nuk i tërhoqi fjalët.

Ndërhyrja e Kryetarit të Kuvendit gjatë fjalës së z. Balić ishte në pajtim me rregullën 22.11 e cila parasheh që “Kryetari i Kuvendit mund ta urdhërojë një deputet ose ministër, që sipas mendimit të tij ka përdorur “gjuhë jo parlamentare” e cila mes tjerash definohet si “sulme personale ose fyerje, ose gjuhë e pahijshme” t’i tërheq fjalët e tilla.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor është shpërndarë më 19 shkurt dhe projektligji për banimin dhe vendqëndrimin u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 26 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht 18 dhe 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 16 mars. Projektligji për bujqësinë organike është shpërndarë më 19 mars. Andaj, projektligji është shpërndarë 17 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare më 16 prill. Projektligji për shoqëritë tregtare është shpërndarë më 17 prill. Andaj, projektligji është shpërndarë 15 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare më 10 maj.

Projektligji për banimin dhe vendqëndrimin dhe projektligji për shoqëritë tregtare janë shqyrtuar në lexim të parë në pajtim me rregullën rregullën 35.1 e cila parasheh që shqyrtimit i parë i projektligjit të bëhet jo më herët se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes. Por projektligji për ndryshimin e ligjit Nr 2003/14 për planifikimin hapësinor dhe projektligji për bujqësinë organike janë shqyrtuar pak më tepër se tri javë pune nga data e shpërndarjes së tyre. Në këtë periudhë është bërë përmirësimi për dallim nga periudhat e mëparshme raportuese kur shumica e projektligjeve janë shqyrtuar për herë të parë pas goxha më shumë se tri javë pune pas datës së shpërndarjes së tyre, por Kuvendi ende ka vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve në pajtim me afatin e përcaktuar në rregulloren e punës, përkundër faktit se mban seanca plenare dy herë në muaj.

Procesi legjislativ

- Projektligji për mbrojtjen nga zhurma është miratuar gati gjashtë muaj pas shqyrtimit të parë më 9 tetor 2006. Projektligji për Bletarinë është miratuar pas më shumë se tre muajve pas shqyrtimit të parë më 14 dhjetor 2006. Projektligji për transfuzionin e gjakut është miratuar gjashtë muaj pas shqyrtimit të tij të parë më 9 tetor 2006. Projektligji për emrin personal dhe projektligji për numrin personal janë miratuar tre muaj pas shqyrtimit të tyre të parë më 11 janar 2007. Projektligji për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse është miratuar gati pesë muaj pas shqyrtimit të parë më 22 dhjetor 2006.

Rregulla 35.6 parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi”. Komisionet e Kuvendit i kanë paraqitur rekomandimet e tyre në të gjitha projektligjet e lartpërmendura me një vonesë të konsiderueshme nga afati i përcaktuar me rregullën 35.6, pa kërkuar nga Kuvendi shtyerjen e afatit. Nëse Kuvendi dëshiron ta rrisë efektivitetin e procesit të tij legjislativ, Komisionet duhet t’i shqyrtojnë projektligjet brenda kohës së paraparë në rregullën e lartëshënuar. Vonesat në shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve poashtu theksojnë nevojën për planifikim më të mirë të planit legjislativ në mes të Kuvendit dhe Qeverisë.

- Në seancën plenare të 3 marsit, z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se LDK-ja e mbështet rekomandimin e Komisionit për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për kthimin e projektligjit për ditën e dëshmorëve Qeverisë si sponsorues. Ai vazhdoi duke thënë se

⁶ Komenti i z. Muhaxheri nuk mund të dëgjohej nga galeria e vëzhguesve.

⁷ Z. Balić e bëri komentin e tij duke i u referuar moshës së shtyrë të z. Muhaxheri.

edhe Qeveria poashtu kishte kërkuar tërheqjen e projektligjit në fjalë nga procedura parlamentare dhe arsyetoi se sipas rregullores së punës, Qeveria ka të drejtë ta tërheq ligjin në çdo kohë. Më 21 mars Komisioni çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka propozuar kthimin e projektligjit për ditën e dëshmorëve Qeverisë për shqyrtim të mëtutjeshëm. Në propozimin e tij komisioni ka shpjeguar se projektligji për ditën e dëshmorëve ishte miratuar në parim në seancën plenare të 20 janarit 2006, pas së cilës komisioni kishte organizuar një dëgjim publik me palët e interesuara për të diskutuar dhe për t'u pajtuar për caktimin e datës për Ditën të Dëshmorëve, por një marrëveshje e tillë nuk ishte arritur për shkak të mospajtimeve mes palëve. Më 8 maj 2006 komisioni kishte kërkuar prej Kryesisë t'i lejojë më shumë kohë për ta shqyrtuar projektligjin, gjë që i ishte lejuar, por prapëseprapë nuk ishte arritur marrëveshja lidhur me datën për Ditën e Dëshmorëve dhe komisioni ka vendosur ta kthejë projektligjin në Qeveri për shqyrtim të mëtutjeshëm. Andaj, Kuvendi e miratoi rekomandimin e Komisionit për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për kthimin e projektligjit për ditën e dëshmorëve në Qeveri për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Në seancën plenare të 10 majit Kryetari i Kuvendit i ka inkurajuar komisionet që ta shfrytëzojnë rregullën 35.7 që u lejon komisioneve t'i shqyrtojnë projektligjet para shqyrtimit të parë, në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektshëm.

Rregulla 35.3 parasheh që “Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim.” Andaj, deklarata më lartë se sponsoruesi ka të drejtë ta tërheqë projektligjin në çdo fazë është jo e saktë. Për më tepër, sipas interpretim analogjik, komisioni për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese (Komision Funkcional) është dashur t'i propozojë Kuvendit që ta kthejë projektligjin për Ditën e Dëshmorëve sponsoruesit në pajtim me rregullën 35.3. Siç përshkruhet në paragrafin më lartë, rregulla 35.6 parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Pas më shumë se tre muajsh shqyrtimi, Komisioni Funkcional ka kërkuar nga Kryesia ta miratojë zgjatjen e afatit për shqyrtimin e projektligjit për ditën e dëshmorëve, por marrja e këtij vendimi i takon Kuvendit dhe jo Kryesisë. Andaj, Komisioni Funkcional është dashur të kërkojë nga Kuvendi të miratojë shtyerjen e afatit për shqyrtimin e projektligjit në fjalë. Siç është përmendur nga Kryetari i Kuvendit, rregulla 35.7 parasheh që “Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.” Sikur Komisioni Funkcional ta kishte shqyrtuar projektligjin në fjalë para leximit të parë, siç lejohet me rregullën 35.7, do t'i kishte vërejtur më herët kontradiktat lidhur me të dhe do të kishte propozuar kthimin e tij sponsoruesit gjatë leximit të parë dhe jo të bëjë një propozim të tillë katërmëdhjetë muaj pas leximit të parë. Është tepër e rekomandueshme që komisionet ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para leximit të parë në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektiv.

Interpelanca

- Më 1 mars grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion për interpelancë ku ka ftuar Ministrin për Ekonomi dhe Financa të shpjegojë “përgjegjësinë e tij lidhur me lejimin e blerjes së veturës së blinduar nga linja buxhetore tjetër.” Në mocionin e saj ORA më tutje ka deklaruar se “Komisioni hetues i Kuvendit ka ardhur në përfundimin se Ministri për Ekonomi dhe Financa nuk i ka respektuar dispozitat ligjore duke lejuar blerjen e veturës së blinduar nga ana e Kryetarit të Kuvendit nga linja buxhetore e ndarë për renovimin e ndërtesës së Kuvendit. Andaj, Ministri për Ekonomi dhe Financa duhet të japë shpjegime lidhur me zbatimin e ligjit për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë.” Më 5 mars Kryesia është pajtuar pa diskutim që mocionin për interpelancë t'ia përcjellë Qeverisë. Më 21 mars Ministri për Ekonomi dhe Financa i ka dërguar letër Kryesisë në të cilën ka deklaruar se është i gatshëm t'i përgjigjet interpelancës. Kryesia në mbledhjen e mbajtur më 27 mars e ka caktuar debatin për interpelancë për seancën plenare të 30 marsit.

Në seancën plenare të 30 marsit z. Nazim Jashari (ORA) e hapi debatin për interpelancën me vërejtje në zbatimin e rregullave të punës lidhur me interpelancat. Ai pohoi se Ministri nuk kishte kthyer përgjigje me kohë në mocionin për interpelancë, siç kërkohet me rregullore të punës së Kuvendit, dhe se Kryesia është dashur ta radhisë interpelancën për debat në seancën plenare të 16 ose 22 marsit pa përgjigjen e Ministrit. Ministri u përgjigj se nuk ka dashur t'i shmanget debatit të interpelancës por ka kërkuar nga Kryesia që mos ta radhisë debatin për interpelancën gjatë javës së dytë të Marsit meqë ai do të shkonte në udhëtim zyrtar. Disa deputetë nga grupe parlamentare të ndryshme bënë deklarata para se debati për interpelancë të përmbyllej nga z. Jashari.

Sipas rregullave të reja 25.5-6 “Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, e cila është e detyruar ta shqyrtojë brenda shtatë (7) ditësh. Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej shtatë (7) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria. Në qoftë se Qeveria në afatin e paraparë me paragrafin 5 nuk e dërgon përgjigjen lidhur me interpelancën, interpelanca vihet si pikë e fundit në rendin e ditës të seancës plenare që është duke u zhvilluar. Nëse Kuvendi nuk është për seancë, atëherë ajo vihet si pikë e parë në rendin e ditës së seancës së parë të radhës të Kuvendit.” Ministri për Ekonomi dhe Financa ka dhënë përgjigjen e tij pesëmbëdhjetë ditë pas dorëzimit të interpelancës, duke kaluar kështu afatin e paraparë me rregullën 25.6. Kryesia ka qenë e obliguar ta përfshijë interpelancën për diskutim në seancën e parë, përkatësisht më 16 mars, pas kalimit të afatit shtatë ditor për përgjigjen e Ministrit. Por, rregulla 25.8 parasheh që “Kryeministri ose ministri të cilit i parashtrohet interpelanca ka për detyrë ta paraqesë dhe të arsyetojë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë”, dhe meqë Ministri kishte deklaruar se ka qenë jashtë vendit gjatë javës së dytë të Marsit, kur edhe është mbajtur seanca e 16 marsit dhe nuk qe në gjendje ta paraqesë mendimin e Qeverisë në seancën në fjalë, Kryesia ka mundur ta përfshijë interpelancën në rendin e ditës të seancës plenare të 22 marsit në vend se ta shtyejë atë edhe për një javë.

- Më 11 prill grupi parlamentar i PDK-së ka parashtruar një mocion për interpelancë ku ka ftuar Ministrin për Miniera dhe Minerale Et’hem Çeku të shpjegojë lëshimin e licencës për kërkim kompanisë “Kosovo Resource” nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM). Në mocionin e tyre PDK ka debatuar se “KPM-ja, duke lëshuar këtë licencë në mënyrë të padrejtë ka tjetërsuar pronën e minierës së Trepçës/Trepça në Drazhnjë/Dražnje. Ka dyshime se ka pasur konflikt interesi dhe parregullsi me rastin e lëshimit të licencës.” Në mbledhjen e mbajtur më 7 maj, Kryesia është pajtuar që t’ia përcjell mocionin për interpelancë Qeverisë.
- Më 18 prill grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion për interpelancë ku ka ftuar Kryeministrin Agim Çeku të shpjegojë “kriteret e Qeverisë për përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.” Në mocionin e tyre ORA ka arsyetuar se “meqë bordet kanë rol të rëndësishëm në definimin e politikave publike dhe në mbikqyrjen e ndërmarrjeve publike, anëtarët e bordeve duhet të kenë kualifikimin e duhur si dhe të jenë të njoftuar me punën e ndërmarrjeve të tilla. Andaj prezantimi i kriterëve për përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve do të ofronte një vështrim të objektivave të Qeverisë lidhur me zhvillimin e ndërmarrjeve publike.” Në mbledhjen e mbajtur më 7 maj, Kryesia është pajtuar që t’ia përcjell mocionin për interpelancë Qeverisë.

Vendimi i Kryesisë për t’ia përcjellur Qeverisë mocionet për interpelancë të parashtruara respektivisht nga PDK-ja dhe ORA ishte në pajtim me rregullën e re 25.5 sipas të cilës “Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, e cila është e detyruar ta shqyrtojë brenda shtatë (7) ditësh.”

Deklarata për mbështetjen e propozimit të të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës

- Në seancën plenare të 5 prillit, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se Ekipi i Unitetit, Kryesia e Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare kishin hartuar një deklaratë për mbështetjen e propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës të të dërguarit të posaçëm të OKB-së dhe lexoi

me zë tekstin e deklaratës “(a) Kuvendi i Kosovës mirëpret raportin final të të Dërguarit Special të OKB-së për procesin e statusit të Kosovës të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007, duke besuar se rekomandimet e tij paraqesin një zgjidhje të drejtë dhe të balancuar që është në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës; (b) Kuvendi i Kosovës e pranon dhe zotohet të implementojë plotësisht propozimin gjithëpërfshirës të marrëveshjes për statusin e Kosovës të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007 dhe deklaron, nën supozimin që marrëveshja është e pranueshme për Këshillin e Sigurimit, se dispozitat që i përmban marrëveshja do të jenë ligjërish të obligueshme për Kosovën; dhe (c) Kuvendi i Kosovës mirëpret pa rezervë praninë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë që do të krijohet në Kosovë, siç parashihet në marrëveshje dhe zotohet se do të bashkëpunojë dhe do ta mbështes këtë prani në çdo mënyrë të mundshme përdërisa kjo prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë t’i kryejë detyrat që i janë dhënë në marrëveshje.”

Kjo ishte në pajtim me rregullën 2 e cila parasheh që deklarata është “deklarim i përgjithshëm politik, që votohet dhe miratohet nga Kuvendi.”

Formimi i grupit të ri parlamentar

- Më 6 mars z. Lulzim Zeneli ka dorëzuar një letër “të bazuar në rregullat 11.1-11.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit” duke njoftuar Kryesinë e Kuvendit se ai dhe deputetët e Kuvendit në vijim kanë vendosur të formojnë një grup parlamentar të quajtur “Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)”: Z. Nexhat Daci, z. Ramadan Kelmendi, znj. Besa Gaxherri, z. Milazim Haliti dhe z. Fadil Geci.⁸ Z. Zeneli e informoi Kryesinë se z. Kelmendi do të shërbente si shef i grupit.

Në fillim të seancës plenare të 16 marsit, z. Ramadan Kelmendi deklaroi se Kryesia ishte njoftuar më 6 mars se “LDD-ja” e kishte formuar grupin parlamentar dhe kërkoi nga Kryetari i Kuvendit që ta informojë Kuvendin në pajtim me rrethanat. Kryetari i Kuvendit u përgjigj duke thënë se Kryesia më parë do të kërkonte komentet e OSBE-së lidhur me këtë çështje.

Në seancën plenare të 30 marsit z. Kelmendi sërish kërkoi nga Kryesia që ta pranoj grupin parlamentar “LDD” në pajtim me Rregulloren e Punës. Kryesuesi u përgjigj se Kryesia së shpejti do ta shqyrtonte këtë çështje.

Në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 10 prill Kryetari i Kuvendit i informoi anëtarët e tjerë se Shefi i Misionit të OSBE-së ka dërguar një letër ku ka shpjeguar se “edhe pse “LDD” akoma nuk është parti politike, sipas rregullores së punës deputetët kanë të drejtë të formojnë grup parlamentar të veçantë nëse kanë qëllim të përbashkët politik dhe nëse numri i deputetëve është së paku gjashtë. Sa i përket çështjes së emrit, grupi i ri parlamentar nuk mund të emërohet “LDD” meqë për momentin ky është emër i një partie politike ende të paregjistruar, emri i së cilës mund të jetë i kontestueshëm.” Anëtarët e Kryesisë e kanë mbështetur vendimin e gjashtë ish-deputetëve të LDK-së për formimin e grupit të tyre parlamentar dhe janë pajtuar që ta funksionalizojnë atë pas regjistrimit të LDD-së si entitet politik dhe pas zgjidhjes së kontestit rreth emrit.

Në fillim të seancës plenare të 27 prillit z. Lulzim Zeneli bëri vërejtjen se “LDD-ja” ende nuk ishte pranuar si grup parlamentar dhe shtoi se ai konsideron se kjo çështje po zhagitet me qëllim. Kryesuesi u përgjigj duke thënë se Kryesia nuk po e pengon pranimin e grupit parlamentar të “LDD-së” por po priste që procesi i regjistrimit të LDD-së të përfundojë dhe të zgjidhet kontesti rreth emrit. Ai deklaroi se beson se kjo çështje do të finalizohet në seancën e radhës.

Më 7 maj Kryesia është takuar me shefat e grupeve parlamentare për të diskutuar për rendin e ditës së seancës plenare të radhës. Z. Kelmendi u paraqit në mbledhje meqë me sa duket ishte ftuar në mbledhje si shef i grupit parlamentar të LDD-së. Duke u thirrur në letrën e cituar më lartë dërguar nga Shefi i Misionit të OSBE-së, Kryetari i Kuvendit i tha z. Kelmendi se nuk

⁸ Gjashtë deputetët e Kuvendit të cilët kanë vendosur ta formojnë grupin parlamentar të “LDD-së” i përkisnin grupit parlamentar të LDK-së.

mund të merrte pjesë në mbledhjet e Kryesisë duke diskutuar se grupi i tij parlamentar nuk mund të quhet “LDD” derisa entiteti politik të mos regjistrohet me atë emër. Z. Kelmendi u përgjigj se partia e tij ishte regjistruar nga OSBE-ja me emrin “Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)” dhe se kontesti rreth emrit nuk ekzistonte më. Kryetari i Kuvendit megjithatë e përsëriti se z. Kelmendi nuk mund të qëndrojë në mbledhje sepse ai nuk kishte marrë ndonjë letër tjetër nga OSBE-ja me të cilën konfirmohet se entiteti politik “LDD” ishte regjistruar. Z. Kelmendi e lëshoi mbledhjen dhe u kthye pak më vonë me kopje të certifikatës së regjistrimit të “LDD-së” dhe u shpërndau anëtarëve të Kryesisë.

Në fillim të seancës plenare më 10 maj Kryetari i Kuvendit lajmëroi se grupi i ri parlamentar i quajtur “Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)” ishte formuar.

Sipas rregullës 11 (Kapitulli IV i Rregullores së Punës), gjashtë ose më shumë deputet të Kuvendit mund të formojnë grup parlamentar bazuar në qëllimin e përbashkët politik, dhe grupi parlamentar i komunikon Kryesisë së Kuvendit emrin e kryetarit të tyre dhe të deputetëve të tjerë.⁹ Andaj, gjashtë ish-deputetë të LDK-së kishin të drejtë të formojnë grupin e tyre parlamentar me rastin e komunikimit të vendimit të tillë Kryesisë, por ata nuk mund të quheshin “LDD” meqë ky ishte emri i një entiteti ende të peregjistruar politik i cili ishte kontestuar. “Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) është regjistruar me këtë emër nga OSBE-ja më 18 prill dhe kontesti lidhur emrin e partisë është shuar të njëjtën ditë. Andaj, njoftimi për formimin e grupit parlamentar të “LDD-së” ka mundur të bëhet në seancën plenare të mbajtur më 27 prill dhe z. Kelmendi është dashur t’i lejohet pjesëmarrja në mbledhjen e Kryesisë mbajtur më 7 maj meqë kontesti lidhur me emrin e partisë politike “LDD” tashmë ishte zgjidhur.

Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 16 marsit nëntë prej dymbëdhjetë pyetjeve morën përgjigje. Gjatë kohës për pyetje në seancën plenare të 16 marsit, z. Xhevat Bislimi (PDK) bëri vërejtjen se nuk kishte marrë përgjigje në pyetjen që ai i kishte parashtruar Kryeministrit katër muaj më parë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se pyetja e z. Bislimi tashmë ishte përfshirë në rendin e ditës së dy seancave të njëpasnjëshme plenare por Kryeministri nuk ishte i gatshëm të ipte përgjigje, duke shtuar se pyetja do të publikohej në Buletinin e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kryesisë mbajtur me shefat e grupeve parlamentare më 27 mars, z. Alush Gashi (LDK) tha se ministrat duhet t’u përgjigjen pyetjeve të deputetëve brenda afatit dhe se publikimi i pyetjeve që nuk marrin përgjigje në buletin nuk është e mjaftueshme.

Në seancën plenare të 30 marsit pesë prej tetë pyetjeve morën përgjigje. Gjatë kohës për pyetje në seancën plenare të 30 marsit, znj. Selvije Halimi (PDK) mori përgjigje në pyetjen e saj nga Ministri për ambient dhe planifikim Ardian Gjini, por ajo e kritikoi Ministrin për përgjigjen e vonuar në pyetjen të cilën ajo e kishte parashtruar para një muaji. Në seancën plenare të 13 prillit dymbëdhjetë prej 17 pyetjeve morën përgjigje. Në seancën plenare të 27 prillit të gjitha pyetjet u shtynë për seancën e radhës meqë Qeveria nuk mund të merrte pjesë gjatë periudhës së pyetjeve sepse ishte në takim me misionin fakt mbledhës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në seancën plenare të 10 majit tetë prej 17 pyetjeve morën përgjigje. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se pyetjet që nuk marrin përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit

Koha për pyetjet parlamentare është kryer nga Kuvendi në pajtim me rregullën e re 26 për “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare duhet të përfshijë kohën prej 50 minutash për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e Ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta përgjigja në pyetjen shtesë.

Sipas rregullës së re 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletinin e Kuvendit.” Buletini i Kuvendit nuk përmban pyetjet që i janë

⁹ Shiko rregullat 11.1 dhe 11.3: “Grupi parlamentar është grupim politik i përbërë nga jo më pak se 5 për qind, përkatësisht 6 deputetë të Kuvendit në funksion të një qëllimi politik të përbashkët . . . Emri i Kryetarit dhe i anëtarëve të grupit parlamentar i komunikohen me shkrim Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit.”

parashtruar Qeverisë, prandaj asnjëra nga pyetjet që nuk ka marrë përgjigje nuk është publikuar ndonjëherë.¹⁰ Në sistemet parlamentare, pyetjet për ministrat paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm për mbikëqyrjen e aktiviteteve të ekzekutivit, andaj është e domosdoshme që Kuvendi t'i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në rregullën 26.11, gjë që do të mund të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë së Qeverisë ndaj Kuvendit.

3. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Më 26 mars Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve i ka dorëzuar Kryesisë propozimin ku ka kërkuar nga Qeveria t'i përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve jo-shqiptare dhe jo-serbe në grupet punuese për hartimin e projektligjeve. Në mbledhjen e mbajtur më 10 prill Kryesia e ka miratuar propozimin e Komisionit dhe i ka përcjellur atë Zyrës së Kryeministrit. Më 9 maj Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit i ka dërguar letër Kryesisë duke e informuar se Qeveria pajtohet me propozimin e komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe ka kërkuar nga Kuvendi që të përgatis listën me ekspertët ligjorë të cilët u përkasin komuniteteve jo-shqiptare dhe jo-serbe, që do të ftohen nga Qeveria për të marrë pjesë në grupet punuese për hartimin e projektligjeve në fushat e ekspertizës së tyre përkatëse.¹¹

4. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, dhe në mbledhjet e komisioneve. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

6. Rekomandimet kryesore

- Rregullat e reja 23.1-2, të cilat kërkojnë që propozimet lidhur me rendin e ditës të parashtrihen me shkrim, duhet të respektohen në mënyrë konsistente me qëllim që të shmanget paqartësia apo paknaqësia në mes deputetëve të Kuvendit.
- Është tepër e rekomandueshme që komisionet e Kuvendit t'i shqyrtojnë projektligjet brenda kohës së paraparë në rregullën 35.6 dhe gjithashtu ta shfrytëzojnë rregullën 35.7, e cila u lejon komisioneve t'i shqyrtojnë projektligjet para leximit të tyre të parë, në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më efektiv.
- Është e domosdoshme që Kuvendi t'i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në rregullën 26.11, gjë që do të mund të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë së Qeverisë ndaj Kuvendit

FUND.

¹⁰ Shiko raportet 01/2007, 07/2006, 06/2006 dhe 05/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar "Pyetjet për Qeverinë".

¹¹ Kjo çështje do të mbulohet më tej në raportin e ardhshëm për monitorimin e Kuvendit të Kosovës.